

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

## PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2014

### SESIONI I

E mërkurë, 18 qershor 2014

Ora 10.00

**Lënda: Filozofi**

**Udhëzime për nxënësin**

Testi në total ka **20 pyetje**.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

**Për përdorim nga komisioni i vlerësimit**

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Kërkesa	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Kërkesa	15	16	17	18	19	20	
Pikët							

Totali i pikëve

**KOMISIONI I VLERËSIMIT**

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Filozofia e Heraklitit është: **1 pikë**
- A) vazhdim i shkollës së Miletit.
  - B) kundërshtimi i ideve të shkollës së Miletit.
  - C) e lidhur me ujin si element bazë i gjithçkaje.
  - D) vlerësim i apejronit si substancë e papërcaktuar.
2. Një pasojë e lëvizjes ideore të sofistëve ishte fakti që: **1 pikë**
- A) nxiti harmoninë mes aristokratëve të Athinës.
  - B) solli deformime në artin e retorikës.
  - C) prodhoi arritje virtuoze në artin e retorikës.
  - D) zhvlerësoi artin e diskutimit.
3. Morali epikurian është kërkim i: **1 pikë**
- A) kënaqësisë.
  - B) pasurisë.
  - C) lavdisë.
  - D) jetës luksoze.
4. Pamundësia e një kriteri të së vërtetës është tipar i: **1 pikë**
- A) stoicizmit.
  - B) skepticizmit.
  - C) sofizmit.
  - D) platonizmit.
5. Në shekullin XIV, raporti arsye-besim u zhvillua në drejtim të: **1 pikë**
- A) kufizimeve të arsyes.
  - B) forcimit të rolit të arsyes.
  - C) nënshtrimit të filozofisë nga feja.
  - D) ndarjes së filozofisë nga feja.
6. Filozofia e Spinozës lidhet ngushtë me konceptin e: **1 pikë**
- A) substancës.
  - B) monadave.
  - C) remineshencës.
  - D) apejronit.
7. Historia, sipas Volterit, mund të na mësojë për të ardhmen, nëse historiani: **1 pikë**
- A) përdor arsyen dhe jo pasionet.
  - B) nuk duhet të shtrembërojë realitetin për interesat e tij.
  - C) nuk duhet t'i ndajë popujt në të zgjedhur dhe raca të ulëta.
  - D) i kryen të gjitha veprimet e mësipërme.
8. Bentham njihet me doktrinën e: **1 pikë**
- A) utilitarizmit.
  - B) ekzistencializmit.
  - C) pozitivizmit.
  - D) komunizmit.

- 9. Te filozofia e së drejtës së Hegelit: 1 pikë**
- A) liria konkurron ashpër domosdoshmërinë e ligjit.  
 B) liria lidhet me domosdoshmërinë e ligjit.  
 C) liria politike shpreh pavarësinë e njeriut nga ligji.  
 D) liria politike është dëshirë dhe jo detyrë përballë ligjit.
- 10. Reforma intelektuale e Kontit synon: 1 pikë**
- A) ndikimin e shoqërisë më tepër nga politika se sa nga morali.  
 B) të zëvendësojë çdo formë të metafizikës me shkencën.  
 C) ta barazojë vlerën e shkencës me metafizikën.  
 D) të zëvendësojë shkencën me metafizikën.
- 11. Nga filozofia e Aristotelit përshkruani:**
- a) kritikën e tij ndaj teorisë së ideve të Platonit \_\_\_\_\_ **2 pikë**  
 \_\_\_\_\_
- b) virtytin \_\_\_\_\_ **2 pikë**  
 \_\_\_\_\_
- 12. Shpjegoni kanonikën e Epikurit lidhur me: 3 pikë**
- a) pasionin \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_
- b) intuitën e gjërave shqisore \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_
- c) ndijimin \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_
- 13. Përshkruani tri prova të ekzistencës së Zotit sipas Akuinit. 3 pikë**
- a) \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_
- 14. Krahasoni shtetin ideal të: 2 pikë**
- a) Platonit \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_
- b) Kampanelës \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_

15. Përshkruani tre momente nga parimi i Traktatit Etik të Dekartit mbi sundimin e vetvetes. **3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

16. Shpjegoni tre momente të rëndësishëm të kuptimit liberal të politikës nga Hobsi. **3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

17. Listoni tre faktorë që Monteskjë i dallon si ndikues në ndërtimin e ligjeve, përveç faktorëve shoqërorë. **3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_

18. Shpjegoni dy momente të empirizmit të Hjumit. **2 pikë**

- a) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

19. Përshkruani tri rryma kryesore që sunduan në shekullin e XX. **3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

20. Shpjegoni filozofinë e Niçes lidhur me: **2 pikë**

a) mbinjeriun \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

b) krijimin e vlerave të reja \_\_\_\_\_ **2 pikë**